



01 Nr. 505/24 Dt. 20.08.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për formimin e Komisionit

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për pranimin teknik të punimeve në projektin: “Ndërrimi i dyerve të klasave me anësore metalike (22 klasa)” në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Dalip Shabanaj,prof i biologjisë,
 - 1.2. Beniamin Ibrahim, farmacist,
 - 1.3. Blend Selmani,doktor.
2. Detyrat e Komisionit do të jenë: të verifikoj punimet e realizuara nga ana e OE “ELK GROUP” shpk nga Gjakova dhe të bëj pranimin teknik të punimeve të realizuar në projektin: “Ndërrimi i dyerve të klasave me anësore metalike (22 klasa) në SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren me nr. të kontratës 622-24-2727-2-3-6/C1383, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit.

